

VENDIM
Nr.40, datë 14.7.2006

**PËR MIRATIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE, PËR PERIUDHËN
1.1.2005 DERI MË 31.12.2005, PËR SHOQËRINE “JUANA” SHPK**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 germa b, 9 dhe 26 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, me ndryshimet e ligjit nr.9512, datë 10.4.2006 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe vendimit nr.60, datë 29.12.2004 të Bordit të Komisionerëve “Për miratimin e të dhënave bazë në lidhje me aplikimin për çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga prodhuesit e vegjël”, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 14.7.2006, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga “Juana” sh.p.k., për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për periudhën 1.1 2005 – 31.12. 2005,

VENDOSI:

1. Çmimi i shitjes së energjisë elektrike të prodhuar nga “Juana” sh.p.k., për periudhën nga 1.1.2005 deri më 31.12. 2005 të jetë 5.35 lekë/kWh.
 2. Ngarkohet “Juana” sh.p.k. dhe KESH sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta